

NEWSLETTER

Publikim i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Mars 2018



Evente & Media

- Drejtori i Përgjithshëm i ftuar në RTSH
- Aftësia e Kufizuar nuk është Paaftësi”
- Promovimi i librit “Zemra që flet” në Klubin e Artit dhe Kulturës SIGAL

Marketing

- Takimi rajonal i grupit SIGAL UNIQA
- SIGAL UNIQA i bashkohet nismës së bashkisë për mbjelljen e pemëve
- “INOVACIONI NE SIGURIME”, konkursi me UET

Tregu i Sigurimeve

- Të dhënat nga AMF për muajin shkurt 2018, SIGAL UNIQA udhëheq tregun

Evente&Media



Takimi rajonal i grupit SIGAL UNIQA

U zhvillua në Durrës, takimi rajonal i SIGAL UNIQA Group Austria, ku morën pjesë drejtuesit e kompanisë, drejtorë departamentesh dhe menaxherë të zyrave të SIGAL UNIQA nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia.

Në takim u diskutua mbi objektivat përkatëse të kompanive në të tre shtetet, objektivat e degëve respektive dhe të punonjësve, primet dhe realizimet etj. Drejtori i Përgjithshëm, Z. Ponari, bëri një pasqyrim të situatës së grupit SIGAL UNIQA për të tre shtetet, duke cekur të gjithë komponentët finaciare, problematikat por edhe përparësitë që ka një emër i madh si SIGAL në tregun shqiptar dhe atë rajonal të sigurimeve.

Drejtori i Përgjithshëm i ftuar në RTSH

Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria, Z. Avni Ponari, ishte i ftuar në RTSH1 në emisionin “Përballë”, për të diskutuar mbi sigurinë në rrugë, për numrin e lartë të aksidenteve që ndodhin në rrugët e Shqipërisë, përse ndodhin, çfarë duhet përmirësuar, përse ka kaq shumë prezencë të policisë nëpër rrugë etj.

Z. Ponari diskutoi për këto problematika me të ftuarit e tjerë, me z. Skënder Ismaili, Shef i Sektorit të Sigurisë Rrugore në Policinë e Shtetit, Spartak Tarka nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe Krenar Ahmeti Ish-Drejtues i Qarkullimit Rrugor.

Emisionin e plotë mund ta ndiqni këtu:

<https://www.facebook.com/RadioTelevizioniShqiptarRTSH/videos/1732495150151350/>

SIGAL UNIQA i bashkohet nismës së bashkisë për mbjelljen e pemëve

Nismës për mbjelljen e 2 milionë pemëve në Pyllin Orbital të Tiranës, iu bashkua edhe SIGAL UNIQA Group Austria dhe ROTARY CLUB TIRANA WEST.

Z. Avni Ponari CEO i SIGAL UNIQA njëkohësisht dhe President i R.C.T.W së bashku me Kryetarin e Bashkisë Z.Erion Veliaj, mbollën 40 pemë bliri, në liqenin artificial të Tiranës.

Kontributi për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit, është një kontribut që u shërben brezave që do të vijnë.

Marketing

“INOVACIONI NE SIGURIME”, konkursi me UET



SIGAL UNIQA në bashkëpunim me Universitetin Europian të Tiranës prezantoi konkursin “INOVACIONI NE SIGURIME”. Për dy muaj, studentët do të ftohen të kryejnë kërkime dhe të propozojnë idetë e tyre novatore mbi tregun e sigurimeve në Shqipëri, sesi mund të zhvillohet ky treg, çfarë përmirësimesh teknologjike mund të ketë, si mundet të depërtohet tek klientët dhe të ndikohet në ndryshimin e mentalitetit të tyre mbi sigurimet etj.

Ky projekt u prazantua nga Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari, në një bashkëbisedim me studentët e UET dhe pedagogët.

Pas paraqitjes së ideve të tyre, do të përzgjidhen edhe idetë më të mira të cilat do të zhvillohen nga ana e studentëve me kërkime konkrete apo me implementimin e programeve specifike, dhe në fund 3 idetë më të mira do të vlerësohen me çmime.

Qëllimi i këtij konkursi është që brezat e rinj të njihen dhe edukohen me sigurimet, si një industri e domosdoshme për qytetarët.

Aftësia e Kufizuar nuk është Paaftësi”

Me mbështetjen e Klubit të Artit dhe Kultures SIGAL, përgjatë muajit mars u zhvilluan disa takime dhe konsultime për projektin: “Aftësia e Kufizuar nuk është Paaftësi”.

Ky projekt do mundësojë shkëmbimin e informacionit, integritetin e politikave vendore e lokale si dhe fuqizimin social-ekonomik të mbi 150 të rinjve me aftësi të kufizuar të qytetit të Durrësit.

Pjesëmarrës për zhvillimin e këtij projekti i cili financohet nga GIZ-Programi ProSEED, ishin: Znj.Meme Xhaferaj -Drejtoreshë e Shërbimit Social, Bashkia Durrës; Z. Indrit Buka - Drejtor i Zyrës së Punës; Z. Dorian Hatibi - Drejtor i DRSHSSH; Znj.Lindita Mukli - Dekane e Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit dhe një grup studentësh; Znj.Adivije Hoxha - Kryetare e Shoqatës të Para-Tetraplegjikëve; Z.Flamur Bala dhe Z.Fadion Buja - si dhe aktivistë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Promovim i librave në Klubin e Artit dhe Kulturës SIGAL

U promovuan në ambientet e Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL, librat e autores Vangjeli Verori Mehmetaj. Në këtë promovim morën pjesë një numër i madh shkrimtarësh e poetësh durrsakë, miq e të afërm të poetes e cila jeton në Itali që nga viti 2001. U promovuan katër libra me poezi në gjuhën shqip dhe një libër me poezi në gjuhën italisht, me titullin "Zemra që flet".

Për vlerën e këtyre librave folën kritiku dhe shkrimtari Shpendi Topallaj, poeti Gjergj Nikolla dhe studiuesi Fatmir Minguli.

Në diskutimet e këtyre referuesve u vu në dukje shpirti poetik i autores si dhe cilësitë e një stili origjinal i përputhur me ndjenjat e shqiptarizms sidomos për durrsakët që jetojnë larg atdheut.

Gjatë promovimit u recituan shumë poezi nga poetja dhe pedagogia Merita Kuçi, poeti Agim Bajrami, shkrimtarja Lumturi Plaku, e cila është emigrante në Itali dhe shumë të afërm e miq të poetes që morën pjesë në këtë promovim të suksesshëm.

Tregu i Sigurimeve

Të dhënat nga AMF, SIGAL UNIQA udhëheq tregun

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është e para në tregun e sigurimeve, me rreth 30% të tregut.

Nga të dhënat e publikuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për muajin janar-shkurt 2018, SIGAL vazhdon të udhëheqë tregun duke zotëruar përkatësisht:

60.42% të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimin e Jetës;

26.83% të volumit të përgjithshëm të primeve për sigurimin e Jo-Jetës

21.87% të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimet Motorike;

45.73% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Pasurisë;

35.56% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim për shoqëritë Jo-Jetë.

Sipas AMF, tregu rezulton me një ulje prej 0.10% më pak se në janar-shkurt 2017. Primet bruto kapën shifrën mbi 2,337 milionë lekë. Numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 168,054 me një rritje prej 3.17% krahasuar me janar-shkurt 2017.

Për më shumë informacion kontaktoni: internal@sigal.com.al

©SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a. 2018